



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 96

Prishtinë, më 2.3.2017, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S1.

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Selvije Halimi, Danush Ademi, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Nezir Çocaj dhe Doruntinë Maloku.

**Munguan :** Albulena Haxhiu, Valdete Bajrami, Pal Lekaj dhe Milena Miliçević.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Avdyl Pajaziti-Klan Kosova, Jehona Zhuniqi-Ekonomia Online, Etrur Maloku-Ambasada Amerikane, Eugen Cakolli-KDI, Dren Ajeti-GLPS, Lumnije Murati-ZPRK, Ardian Bajraktari-MD, Blerta Bejtullahu-EUSR/Euoffice, Lukatz Korecki-EUSR, Cejary Michalcik-EUSR.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
3. Shqyrtimi i amendamenteve të Grupit Punues në Projektligjin nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;**

**Selvije Halimi**, nënkryetare, paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin 05/L- 150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

**REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-209, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
3. **Shqyrtimi i amendamenteve të Grupit të Punës në Projektligjin nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;**

**Armend Zemaj**- Komisioni për Legjislacion në vitin e kaluar ka bërë monitorimin e këtij ligji dhe erdhi në përfundim se disa çështje janë pjesë e mosimplementimit të plotë dhe mbi të gjitha ka edhe rekomandime për Ministrinë e Drejtësisë që duhet të ndryshojnë apo avancojnë disa çështje që kanë të bëjnë me ekzekutimin e sanksioneve penale. Në dëgjimin publik që është mbajtur pati sugjerime dhe vërejtje, të cilat nuk ishin edhe shumë përmbajtjesore, përveç një sugjerimi që ka ardhur nga zyra e BE-së, ku është kërkuar ndarja e të burgosurve sipas kriteve dhe propozimi tjetër nga deputeti Nait Hasani, që nuk është përkrahur nga grupi punues për arsye ligjore.

**Selvije Halimi**- Hap diskutimin që të fshihet paragrafi 6, i nenit 19 të Projektligjit .

Përfaqësuesi nga zyra e BE-ja në Kosovë tha se neni 19 paragrafi 6 dhe neni 18, paragrafi 2, të propozuar që të fshihen nga Projektligji, përfaqësuesi nga zyra e BE-së tha se pajtohet që këto dy nënparagrafe të fshihen.

**Selvije Halimi** sqaroi para komisionit amendamentin e deputetit Nait Hasani, i cili ka propozuar që pjesë e nenit 17 të Ligjit Bazik për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, pas paragrafit 2, të shtohet paragrafi i ri.

*Në lidhje me këtë propozim u hap debat në komision.*

**Armend Zemaj** tha se kjo çka është propozuar nga deputeti Nait Hasani është diskutuar edhe më herët, nuk është si ide e re, por megjithatë mendoj se tani ky propozim nuk e ka vendin në këtë Projektligj. Ai tha se është mirë që ky propozim në të ardhmen të jetë si rekomandim për Ministrinë e Drejtësisë që të rishikohet kjo fushë në tërësi dhe pastaj ti silllet Kuvendit një propozim i ri lidhur me këtë çështje.

**Selvije Halimi**- Propozimi që ka ardhur nga deputeti Hasani është propozim të cilin e kanë pothuajse të gjitha shtetet e BE-së, por me ndryshime. Halimi tha se në seancë plenare do të kërkojë që në periudhën 6 deri 9 muaj, krahas rishikimit të pakos ligjore për sistemin e drejtësisë të shqyrtojë me seriozitet edhe këtë mundësi që të bëhet plotësim ndryshimi edhe i ligjeve tjera si: Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe ligjeve tjera, ku mund të hyjë edhe kjo përlllogaritje e një ditë qëndrimi në burg.

**Doruntinë Maloku** tha se kundërshton fuqishëm propozimin e deputetit Nait Hasani, gjithashtu propozimin e znj. Halimi dhe shtoi se llogaritja e një dite burg si 24 orë, nuk përbën shkelje të të drejtave të njeriut në bazë të asnjë konvente ndërkombëtare. Ajo më tej tha se krahasimi i Kosovës me vendet e BE-së nuk qëndron, kur dihet se ka vende në BE, ku kanë filluar të mbyllin burgjet në mungesë të të burgosurve. Deputetja Maloku propozoi që ky amendament të mos votohet nga anëtarët e Komisionit.

Me një votë për (Nezir Çoçaj), tre kundër (Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Armend Zemaj) dhe tre abstenime ( Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu), nuk u përkrah amendamenti i deputetit Nait Hasanit.

Komisioni, në mënyrë unanime u pajtua që raporti me amendamente të procedohet për shqyrtim në Komisionet e përhershme dhe në Kuvend dhe lidhur me këtë nxori:

### **Rekomandim**

- I. Miratohet Raporti me amendamente.
- II. Projektligji nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore dhe në Kuvend;
- III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

#### **4. Të ndryshme.**

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:05

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetare e Komisionit,

---

**Selvije Halimi**

## **Aneks-Amendamentet e Grupit Punues në Projektligjin nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;**

### **Amendamenti 1**

#### **Propozim i deputetit Nait Hasani pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.**

Propozoj që pjesë e nenit 17 i Ligjit bazë, për ekzekutimin e sanksioneve penale, pas paragrafit 2, të shtohet një paragraf i ri si vijon:

“ 1 një ditë (24 orë) e kaluar në ekzekutim të dënimit me burgim është e barasvlershme me një ditë e gjysmë ( 36 orë ) të kaluar në liri”.

### **Amendamenti 2**

**Neni 2** i Projektligjit,teksti “Në nenin 31 të Ligjit, pas paragrafit 2 shtohen një paragraf i ri si vijon” **zëvendësohet me tekstin** “ *Neni 31 i Ligjit, pas paragrafit 2 shtohen një paragraf i ri 2a, me tekstin si vijon.*” Pjesa tjetër mbetet si në Projektligj.

### **Amendamenti 3**

**Neni 5** i Projektligjit, neni i ri i propozuar 43b **hiqet**.

### **Amendamenti 4**

**Në nenin 9** të Projektligjit, paragrafi 6 në rreshtin e nëntë, fjalët “Ministri i Drejtësisë themelon me rregullore procedurën për punësimin e të dënuarve, pezullimin dhe lirimin e të dënuarve nga puna.” **zëvendësohen** me fjalët “Ministri i Drejtësisë me akt nënligjor përcakton procedurën për punësimin e të dënuarve, pezullimin dhe lirimin e të dënuarve nga puna.”

### **Amendamenti 5**

**Në nenin 10** të Projektligjit, paragrafi 3 i propozuar, në rreshtin e pestë, fjala “rregullore” zëvendësohet me fjalët “**akt nënligjor**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

### **Amendamenti 6**

**Neni 12** i Projektligjit, paragrafi 2 riformulohet si vijon:

“2. Me kërkesë të personit të dënuar, ose anëtarit të familjes së ngushtë, ose me propozim të drejtorit të institucionit Korrektues dhe me rekomandim të drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, i cili mbështet, kundërshton apo abstenon nga kërkesa, kryetari i Gjykatës Themelore, kompetente mund të lejojë, pezullim të përkohshëm të një dënimi me burgim, nëse është vërtetuar se:”

### **Amendamenti 7**

Në nenin 12 të Projektligjit, paragrafi 4 në rreshtin e tretë, fjala “**jepet**” zëvendësohet me fjalën “**lejohet**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

#### **Amendamenti 8**

**Neni 12** i Projektligjit, nënparagrafi 4.2 **hiqet**.

#### **Amendamenti 9**

Në nenin 12 të Projektligjit, paragrafi 6, fjalët “**me institucionin korrektues**” hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

#### **Amendamenti 10**

Në nenin 12 të Projektligjit, paragrafi 7, në rreshtin e gjashtë, pas fjalëve “2 të këtij neni” vendoset pikë dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

#### **Amendamenti 11**

**Neni 18** i Projektligjit, paragrafi 1, në rreshtin e tetë pas fjalëve “Gjykatës Themelore” shtohen fjalët “në Prishtinë” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

#### **Amendamenti 12**

**Neni 18** i Projektligjit, paragrafi 2 **hiqet**.

#### **Amendamenti 13**

**Neni 19** i Projektligjit, paragrafi 6 **hiqet**.

#### **Amendamenti 14**

**Neni 20** i Projektligjit fjalët “**së para institucionit korrektues**” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

#### **Amendamenti 15**

**Neni 22** i Projektligjit riformulohet si vijon:

#### **Neni 22**

Në nenin 219 të Ligjit, paragrafi 2 riformulohet si vijon:

“2. Me akt nënligjor të cilin e nxjerr ministri përcaktohen gradat e zyrtarëve korrektues, kontrollimi i së kaluarës së tyre, periudha provuese dhe promovimi.

2.1 Me akt nënligjor që e nxjerr Qeveria rregullohen pagat dhe beneficionet e tjera.”